

20040661215

L I G J I PËR PËRMENDORET MEMORIALE DHE SHËNIMET- PËRKUJTIMORE

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen çështjet lidhur me shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të dalluara me përmendore memoriale dhe shënime përkujtimore, kushtet dhe procedura për ngritjen e përmendoreve memoriale dhe shënimeve përkujtimoreve, subjektet përgjegjës për ngritjen e tyre, mbrojtjen, ruajtjen, regjistrat për evidentimin e tyre, si edhe mbikëqyrja dhe kontrolli në zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

Neni 2

Me ngritjen e përmendoreve memoriale dhe shënimeve përkujtimoreve, shënohen ngjarje të rëndësishme dhe persona të dalluar nga historia dhe kultura e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, të popullit maqedonas si edhe qytetarëve të cilët jetojnë në kufijtë e saj, të cilët janë pjesë të popullit shqiptar, popullit turk, popullit vllleh, popullit sërëb, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve, si edhe historia dhe kultura në përgjithësi, që janë me rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin shoqëror të Republikës së Maqedonisë, me çka kontribuohet për realizimin dhe përparimin e lirive dhe të drejtave të qytetarëve si edhe për afirmimin, zbatimin dhe respektimin e parimeve të humanizmit dhe vlerave të përgjithshme civilizuese.

Neni 3

Përmendore memoriale, në kuptim të këtij ligji, janë objekte e veçanta ose grup objektësh dhe vepra monumentale të arkitekturës, skulpturës, pikturës dhe artit të aplikuar me përmbajtje historike dhe artistike dhe vlera të cilat ngriten për ruajtjen e përhershme të kujtimit të ngjarjeve dhe personaliteteve nga neni 2 i këtij ligji, e të cilët janë me rëndësi të jashtëzakonshme për Republikën e Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: përmendore memoriale).

Ngjarjet dhe personalitetet që shënohen me përmendore memoriale, duhet të kenë rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shtetësisë së Republikës të Maqedonisë dhe për kontinuitetin e saj juridik-shtetëror dhe të jenë të inkuorpuara në zhvillimin historik të vendit.

Neni 4

Shënime përkujtimore sipas këtij ligji janë bustat, skulpturat, pllakat, çeshmet, shadërvanet dhe veprat tjera artistike dhe arkitektonike dhe krijimtari të cilat me përmbajtjet dhe karakteristikat e veta shënojnë ngjarje dhe personalitete nga neni 2 i këtij ligji ose nga tradita popullore, që kanë rëndësi lokale (në tekstin e mëtejshëm: shënime- përkujtimore).

Neni 5

Përmendore memoriale mund të ngrejë Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në pajtim me këtë ligj.

Iniciativë për ngritjen e përmendores memoriale mund të paraqesin, si edhe të deponojnë mjete për ngritjen e saj: Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe organet e administratës shtetërore, njësitë e vetadministrimit lokal, institucione, shoqata të qytetarëve dhe fondacione, persona tjerë juridikë të interesuar dhe qytetarë.

Shënime përkujtimore mund të ngrejë komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, në pajtim me këtë dhe me ligj tjetër.

Persona juridikë dhe fizikë mund t'i paraqesin iniciativë këshillit të komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit për ngritjen e shënimeve përkujtimore, si edhe të deponojnë mjete për ngritjen e tij.

Shtetas të huaj dhe persona pa shtetësi mund të investojnë mjete për ngritjen e përmendores memoriale, përkatësisht shënimeve përkujtimore.

II. PËRMENDORET MEMORIALE

Neni 6

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, për ngjarjet dhe personalitetet nga neni 2 i këtij ligji që duhet të shënohen me përmendore memoriale, miraton Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të dalluara me përmendore memoriale (në tekstin e mëtejme: Program), për një periudhë pesëvjeçare.

Neni 7

Programi nga neni 6 i këtij ligji posaçërisht përmban:

- ngjarje dhe personalitete që do të shënohen;
- të dhëna për ngjarjet dhe personalitetet dhe rëndësinë e tyre;
- llojin dhe përmbajtjen e përmendores memoriale;
- vendin ku do të ngritet përmendorja memoriale;
- porosia të cilën duhet ta simbolizojë përmendorja memoriale;
- elementet themelore për tekstin i cili do të theksohej (vendosej) në përmendoren memoriale;
- burimi i mjeteve për financimin e ngritjes dhe promovimit publik të përmendores memoriale;
- afati për ngritjen e përmendores memoriale.

Programi përmban edhe të dhëna për llojin, përmbajtjen dhe vendin e shënimeve të deritanishme të ngjarjes dhe personalitetit që shënohet.

Neni 8

Për çdo përmendore memoriale të përmbajtur në programin nga neni 6 i këtij ligji, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë merr vendim për ngritjen e përmendores memoriale, me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, me ç'rast domos duhet të ketë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Në vendim posaçërisht përcaktohet:

- personi përgjegjës përkatësisht trupi përgjegjës për realizimin e iniciativës për ngritjen e përmendores memoriale;
- personi juridik i cili do të administrojë dhe do të kujdeset për ruajtjen, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e përmendores memoriale;
- mjetet e nevojshme për realizimin e iniciativës dhe burimet e mjeteve;
- burimi i mjeteve të nevojshme për ruajtjen e përmendores memoriale;
- lloji dhe përmbajtja e përmendores memoriale;
- vendi ku do të ngritet përmendorja memoriale dhe
- afati për ngritjen e përmendores memoriale etj.

Neni 9

Për zbatimin e procedurës për ngritjen e përmendores memoriale, kujdeset dhe është trup përgjegjës Këshilli për ngritjen e përmendores memoriale (në tekstin e mëtejme: Këshilli) i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Këshillin e përbëjnë kryetari dhe tetë anëtarë, të cilët zgjedhen nga radhët e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, arkitektë, teknologë, historianë, individë shkencorë, kulturorë dhe tjerë, me mandat deri në përfundimin e përmendores memoriale.

Neni 10

Këshilli veçanërisht i kryen punët vijuese:

- shpall konkurs publik për përpilimin e projektit ideor për ngritjen e përmendores memoriale;
- shqyrton çështjet e përgjithshme dhe propozon masa dhe aktivitete që kanë të bëjnë me ngritjen e përmendores memoriale;
- përcjell ekzekutimin e vendimit për ngritjen e përmendores memoriale dhe për të me raport e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.
- kryen edhe punë të tjera në pajtim me vendimin për ngritjen e përmendores memoriale dhe rregullave tjera që kanë të bëjnë me realizimin e aktiviteteve në kompetencë të Këshillit.

Puna e Këshillit rregullohet më së afërmi me rregullore pune.

Punët profesionale dhe administrative-teknike për Këshillin i kryen shërbimi profesional i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Neni 11

Këshilli shpall konkurs publik për përpilimin e projektit ideor për ngritjen e përmendores memoriale (në tekstin e mëtejme: konkurs) dhe kujdeset për zbatimin e procedurës së konkursit dhe për zgjedhjen e projektit ideor i cili do të realizohet.

Neni 12

Konkursi për përpilimin e projektit ideor për ngritjen e përmendores memoriale është anonim, ndërsa rezultatet e konkursit shpallen në shtypin ditor.

Afati për paraqitjen në konkurs zgjat 30 ditë nga dita e shpalljes së konkursit, ndërsa afati i fundit për zgjedhjen e projektit ideor për ngritjen e përmendores memoriale zgjat 90 ditë nga dita e mbarimit të konkursit.

Neni 13

Konkursi për përpilimin e projektit ideor për ngritjen e përmendores memoriale veçanërisht përmban:

- përshkrimin e llojit dhe përmbajtjen e përmendores memoriale;
- vendpozitën ku do të ndërtohet përmendorja memoriale;
- elemente themelore për tekstin i cili do të vendoset në përmendoren memoriale;
- dokumentacionin e duhur dhe shtojcat që duhet t'i përmbajë projekti ideor;
- vlerën parallogaritare të përmendores memoriale;
- shumat e shpërblimeve, blerjet eventuale dhe mënyrën e rregullimit të së drejtës së autorit;
- afatin për paraqitje në konkurs dhe
- kushte tjera me rëndësi për përpilimin e projektit ideor.

Neni 14

Në konkurs mund të marrin pjesë persona fizikë dhe juridikë të vendit dhe të huaj. Pjesëmarrësit në konkurs paraqiten me shifra.

Neni 15

Projekti ideor duhet të jetë i përshtatshëm për ekspozim dhe shfaqje.

Këshilli është i obliguar që projektet ideore t'i ekspozojë publikisht.

Këshilli me shumicë votash e zgjedh projektin ideor për përmendoren memoriale që do të ngritet dhe për atë e informon Kuvendin e Republikës së Maqedonisë.

Neni 16

Ndaj përmendores memoriale të ndërtuar ose në afërsinë e saj të drejtpërdrejtë nuk mund të ndërmerren veprime me të cilat mund të çrregullohet integriteti i përmendores memoriale, pa pajtimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, të autorit dhe të personit juridik nga neni 8, paragrafi 2, alineja 2 e këtij ligji.

Përmendorja memoriale mund të zhvendoset përkatësisht të mënjanohet, me vendimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, pas pëlqimit paraprak të personit juridik nga neni 8, paragrafi 2, alineja 2 e këtij ligji.

Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me vendim e rregullon mënyrën e dhënies së pëlqimit për kryerjen e ndryshimeve në përmendoren memoriale të ngritur ose për ndërmarrjen e veprimeve në afërsinë e saj të drejtpërdrejtë, me të cilat mund të çrregullohet integriteti i përmendores memoriale, për zhvendosjen e saj si edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me përmendoren memoriale.

Shpenzimet për zhvendosjen, përkatësisht mënjanimin i bart investuesi me kërkesën e të cilit bëhet zhvendosja përkatësisht mënjanimi i përmendores memoriale.

III. SHËNIMET - PËRKUJTIMORE

Neni 17

Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit për shënimin me shënime përkujtimore të ngjarjeve dhe personaliteteve nga neni 2 i këtij ligji që kanë rëndësi lokale, miraton Program për shënimin e ngjarjeve të rëndësishme dhe personaliteteve të dalluara me shënime përkujtimore (në tekstin e mëtejme: Programi i komunës) i cili nxirret për një periudhë pesëvjeçare.

Programi i komunës miratohet me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit të komunave, të Qytetit të Shkupit dhe të komunave në Qytetin e Shkupit, me ç'rast domos duhet të ketë shumicë votash të anëtarëve të pranishëm të këshillit, të cilët u takojnë bashkësive që nuk janë shumicë e popullatës në komunat, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat e Qytetit të Shkupit.

Neni 18

Për ngritjen, ruajtjen, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e shënimeve përkujtimore, këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit merr vendim.

Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit emëron Këshill për ngritjen e shënimeve përkujtimore.

Dispozitat nga neni 10 deri më 16 të këtij ligji zbatohen në mënyr përkatëse edhe në shënimet - përkujtimore.

Neni 19

Këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit, me vendim e rregullon edhe çështjen e dhënies së pëlqimit për kryerjen e ndryshimeve në shënimet përkujtimore ose për ndërmarrjen e veprimeve në afërsinë e saj të drejtpërdrejtë, me të cilat mund të çrregullohet integriteti i shënimit përkujtimor, për zhvendosjen e tij si edhe çështje tjera që kanë të bëjnë me shënimin përkujtimor.

IV. REGJISTRAT E PËRMENDOREVE MEMORIALE DHE SHËNIMEVE - PËRKUJTIMORE

Neni 20

Për përmendoret memoriale dhe shënimet përkujtimore të ngritura mbahen regjistra të posaçëm.

Regjistrin e përmendoreve memoriale e mban organi i administratës shtetërore kompetent për punët nga lëmi i kulturës (në tekstin e mëtejme: Ministria), ndërsa regjistrat e shënimeve përkujtimore i mbajnë komunat, Qyteti i Shkupit dhe komunat në Qytetin e Shkupit, për rajonin e vet.

Ministria mban regjistër qendror për shënimet përkujtimore në tërë territorin e shtetit.

Përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrave nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni, më së afërmi i përcakton ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga lëmi i kulturës (në tekstin e mëtejme: ministri).

Neni 21

Regjistrimi i përmendores memoriale në regjistrin e përmendoreve memoriale bëhet në bazë të fletëparaqitjes.

Fletëparaqitje për regjistrimin e përmendores memoriale në regjistrin e përmendoreve memoriale paraqet Këshilli nga neni 9 i këtij ligji.

Fletëparaqitje për regjistrimin e shënimit përkujtimor në regjistrin e shënimeve përkujtimore paraqet Këshilli nga neni 18, paragrafi 2 i këtij ligji.

Fletëparaqitjet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni dorëzohen në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit për shfrytëzimin e përmendores memoriale përkatësisht të shënimit përkujtimor.

Për shkak të regjistrimit të shënimit përkujtimor në regjistrin qendror të shënimeve përkujtimore, këshilli i komunave, i Qytetit të Shkupit dhe i komunave në Qytetin e Shkupit, është i obliguar t'i paraqesë Ministrisë ekstrakt nga regjistri nga paragrafi 2 i këtij neni, në afat prej 15 ditësh nga dita e regjistrimit të kryer në regjistrin komunal, përkatësisht ndryshimin e tij.

Neni 22

Regjistrat e shënimeve përkujtimoreve në komunat, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat në Qytetin e Shkupit në të cilat përveç gjuhës maqedonishte dhe alfabetit të saj cirilik, zyrtare është gjuha dhe alfabeti të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, mbahen në gjuhën maqedonishte dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin të cilën e flasin së paku 20% të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë në rajonin e atyre komunave, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit.

V. DISPOZITAT E POSAÇME

Neni 23

Për mbrojtjen e përmendoreve memoriale dhe shënimeve përkujtimore, të cilave në pajtim me ligjin u është caktuar statusi i trashëgimisë kulturore, zbatohet Ligji për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Neni 24

Në ngritjen e përmendores memoriale dhe shënimit përkujtimor zbatohen rregullat për ndërtimin e objekteve investuese dhe rregullat për planifikimin hapësinor dhe urbanistik.

Neni 25

Leje për ndërtim të përmendores memoriale dhe shënimit përkujtimor lëshon organi kompetent në pajtim me ligjin.

Leje nga paragrafi 1 i këtij neni nuk guxon të lëshohet nëse përmendorja memoriale, përkatësisht shënimi përkujtimor nuk janë përfshirë në programin nga neni 6, përkatësisht në programin nga neni 17 i këtij ligji dhe nëse për to nuk janë marrë vendimet nga neni 8, përkatësisht neni 19 i këtij ligji.

VI. MBIKËQYRJA DHE KONTROLI

Neni 26

Mbikëqyrje dhe kontroll në zbatimin e këtij ligji bën Ministria.

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes në punën e organeve të komunës, Ministria i kryen punët vijuese:

- e përcjell ligjshmërinë e punës së organeve të komunës dhe ndërmerr masa dhe aktivitete dhe paraqet iniciativa për realizimin e kompetencave të komunës në pajtim me këtë ligj;
- vlerëson nëse organet e komunës sigurojnë që kompetencat e komunës të ekzekutohen në pajtim me standardet dhe procedurat e caktuara me këtë ligj;
- jep rekomandime për zbatimin konsekuent të kompetencave të komunës në suazat e përcaktuara me këtë ligj, me kërkesën e organeve të komunës;
- e përcjell nxjerrjen e me kohë të dispozitave të komunës;
- jep mendim dhe ndihmë profesionale për propozimdispozitat e komunës, me kërkesën e organeve të komunës;
- me kohë i lajmëron organet e komunës për gjendjen e konstatuara në punën e tyre dhe për masat e ndërmarra gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

Mbikëqyrje inspektuese në zbatimin e këtij ligji kryen Ministria përmes inspektorëve të kulturës, në pajtim me Ligjin për kulturën dhe Drejtoria për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Lidhur me zbatimin e dispozitave për ndërtim investues dhe planifikim urbanistik, mbikëqyrje dhe kontroll, bëjnë organet kompetente për punët për ndërtim investues dhe planifikim urbanistik.

VII. DISPOZITAT NDËSHKUESE

Neni 27

Ai që do të dëmtojë ose zhdukë përmendore memoriale nga neni 1 dhe 2 i këtij ligji, do të dënohet për vepër penale me dënim me para ose me burg deri më tre vjet.

Ai që do të ngrejë përmendore memoriale ose shënim përkujtimor me të cilat nxitet ose ndizet urrejtje etnike, racore ose fetare dhe përçarje ose të cilat janë në kundërshtim me rendin kushtetues, do të dënohet për vepër penale me dënim me para ose me burg deri më tre vjet.

Në rast posaçërisht të rëndë të veprës nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni, kryerësi do të dënohet me burg prej gjashtë muajsh deri më pesë vjet.

Për veprën nga paragrafi 2 i këtij neni, gjykata do të shqiptojë edhe masë mbrojtëse, mënjanim të përmendores memoriale ose shënimit përkujtimor.

Neni 28

Me dënim me para prej 200.000 deri më 300.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse ngren përmendore memoriale ose shënim përkujtimor që nuk janë të përfshira në programin nga neni 6 ose në programet nga neni 18 i këtij ligji.

Me dënim me para nga paragrafi 1 i këtij neni do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse ngren përmendore memoriale ose shënim përkujtimor pa leje nga neni 24 i këtij ligji.

Me dënim me para prej 30.000 deri 50.000 denarë do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik për kundërvajtje nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni.

Me dënim me para prej 30.000 deri 50.000 denarë do të dënohet edhe personi fizik për kundërvajtje nga paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 dhe 2 të këtij neni, personit juridik dhe fizik mund t'u shqiptohet masë sigurie, mënjanim të përmendores memoriale përkatësisht shënimit përkujtimor.

Neni 29

Me dënim me para prej 100.000 deri 200.000 denarë do të dënohet për kundërvajtje personi juridik nëse:

- ndërmerr veprime në përmendoren memoriale të ndërtuar ose në afërsinë e saj të drejtpërdrejtë, me të cilat mund të çrregullohet integriteti i përmendores memoriale, pa pajtimin e autorit dhe të subjektit të cilit i është besuar mbrojtja e përmendores memoriale (neni 16 paragrafi 1);

- zhvendos përmendore memoriale pa pajtimin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (neni 16 paragrafi 2) dhe

- bën ndryshime të shënimeve përkujtimore ose në afërsinë e tij të drejtpërdrejtë, me të cilat mund të çrregullohet integriteti i përmendores memoriale, ose zhvendos shënim përkujtimor pa pajtimin e subjektit, të cilit me aktin nga neni 19 i këtij ligji i është besuar dhënia e pajtimit të tillë (neni 19).

Me dënim me para prej 30.000 deri 50.000 denarë do të dënohet edhe personi përgjegjës te personi juridik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni.

Me dënim me para prej 20.000 deri 50.000 denarë do të dënohet edhe personi fizik për kundërvajtjen nga paragrafi 1 alinea 1, 2 dhe 3 të këtij neni.

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30

Programi nga neni 6 i këtij ligji do të miratohet në afat prej 1 viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Programi nga neni 17 i këtij ligji do të miratohet në afat prej një viti nga dita e konstituimit të këshillit.

Neni 31

Ministria do të nxjerrë dispozitë nga neni 20 paragrafi 4 i këtij ligji në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Deri në nxjerrjen e dispozitës nga paragrafi 1 i këtij neni, do të vazhdojë të zbatohet Rregullorja për mënyrën e mbajtjes së regjistrave të përmendoreve dhe të shënimeve përkujtimore ("Gazeta zyrtare e RSM" nr.5/83).

Neni 32

Në afat prej dy vitesh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në regjistrat nga neni 20 i këtij ligji do të bëhet regjistrimi i përmendoreve dhe i shënimeve përkujtimore të ngritura deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në pajtim me Ligjin për përmendoret dhe shënimet përkujtimore ("Gazeta zyrtare e RSM" nr.31/82,51/88 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 12/93).

Përmendoret dhe shënimet tjera përkujtimore të ngritura para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të shënohen në regjistrat për regjistrim, në bazë të vendimit për ekzistimin e kushteve për regjistrim të miratuara nga ministri, pas pëlqimit paraprak të komisionit.

Komisionin nga paragrafi 2 të këtij neni e formon ministri dhe përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarëve, personave profesionalë dhe kompetentë.

Me vendimin nga paragrafi 2 i këtij neni do të përcaktohet edhe subjekti i cili do të jetë kompetent për ruajtjen, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e tyre të mëtejme.

Kundër vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund t'i paraqitet ankesë komisionit të Qeverisë të Republikës së Maqedonisë. Ankesa nuk e shtynë vendimin.

Neni 33

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, pushon të vlejë Ligji për përmendoret dhe shënimet përkujtimore (“Gazeta zyrtare e RSM” nr. 31/82, 51/88 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 12/93).

Neni 34

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.